



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 8608/2022  
Data: 10.10.2022

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 20.09.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkyryetari i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Abduraman Bushi** (Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Arsim Dernjani** (Drejtore për Shërbime Publike), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.
3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.
4. Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.
5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- krahas pikave të rendit të punës të cilat i kemi përcjell kemi edhe një pikë shtesë të rendit të punës, Kërkosë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Për pika e rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- për pikën shtesë të rendit të ditës është mirë me na dhënë sqarime më shumë drejtoresha.

**Kryesuesi** thekson:- drejtoresha do të jepë sqarime kur do të diskutohet kjo pikë. A keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

## **Procedojmë me këtë rend të Punës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.
3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.
4. Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.
5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.
6. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

### **2. Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- normalisht është dashur të dërgohen në mënyrë tabelare prej sistemit të BDMS por nuk kam pasur qasje por nga qeveria na është lëshuar në muajin shtatorë dhe jemi duke i proceduar të dhënat në sistem dhe ato të dhëna i keni përpara. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore me qytetarët. Për vitin 2023 buxheti është në shumë prej 3,349,715 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2024 janë në shumë prej 3,569,968 € dhe për vitin 2025 janë në shumë prej 3,713,992 €. Të hyrat vetanake për vitin 2023 parashihen të janë në shumë prej 560,121.00 €. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashroni.

**Refet Kalisi** thekson:- ndërtimi i pendës në vendin e quajtur Sarasell në fshatin Seçishtë janë paraparë 5000€ dhe konsiderojë se ma ato mjete financiare nuk mund të kryhet ky projekt .

**Kryesuesi** thekson:- është e vërtet që me këto mjete nuk mund të rregullohet ky projekt por në të ardhmen nëse rregullohet mund të furnizohet me ujë fshati Seçishtë dhe Lagjja e Re.

**Refet Kalisi** thekson:- e kuptoj që është në interes të qytetarëve por mos ti lëmë në letër sikur i kemi lënë ne. Projekti në fjalë është i kushtueshëm për shkak se fillimi i duhet të bëhet studimi i fizibilitetit në mënyrë që të dihet se a ka ujë të mjaftueshëm, a ka rrezikshmëri dhe pastaj me filluar me u realizuar si projekt.

**Nora Xhoni** thekson:- projekti i rregullimit të shtratit ekziston qe pesë vite si kod dhe është mirë të jetë si kod sepse mund të realizohet si projekt përmes donatorëve.

**Refet Kalisi** thekson:- unë mendoj se është dashur me i planifikuar disa mjete financiare për blerjen e pronës që është planifikuar për shkollë.

**Sevdi Dernjani** thekson:- gati OJQ-ja nuk ka qenë dhe i kemi pasur afate e limituar për me bërë shpërndarjen e buxhetit.

**Sherif Berisha** thekson:- nuk është parapri projekti për rrugën transit në fshatin Gorancë , a ekziston mundësi që së paku një distancë prej pesëqind metrave vetëm stazën me hapur në atë pjesë sepse do t'i ndihmonte fshatit Gorancë .

**Sevdi Dernjani** thekson:- sa i përket rrugës tranzitë në vitin 2024 janë paraparë 30 000 € dhe në vitin 2023 nuk është paraparë për shkak se nuk janë gati më çështjen e parcelave dhe në momentin që administratori i fshatit e siguron çështjen e nënshkrimit të banorëve të cilët déklarohen se i lëshojnë parcelat komuna do të intervenon.

**Sherif Berisha** thekson:- sipas informacioneve që kam nënshkrimet ekzistojnë por nuk e di a janë valide dhe viti 2024 po më doket që është pak gjatë dhe unë po kërkojë vetëm pesëqind metra me u bërë rruga e transitit.

**Sevdi Dernjani** thekson:- për këtë çështje kemi diskutuar me administratorin e fshatit Gorancë por ka potencuar që nuk i ka nënshkrimet por edhe nëse janë nënshkrimet duhet të bisedojmë përsëri me banorët se a janë në dakord mi lëshuar pronat.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoj sqarim për mjetet të cilat janë planifikuar për rregullimin e parkut te rruga "Isa Berisha" , asfaltimi dhe ndriçimi publik.

**Nexhmedin Daci** thekson:- janë planifikuar këto mjete për shkak se nuk mund të kryhet projekti me mjetet të cilat janë planifikuar në këtë vit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTU BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2023 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2024-2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

##### **3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- propozoj që të hiqet si pikë informata e legalizimeve për shkak se ligji ka përfunduar

**Kryesuesi** thekson:-mendoj që është mirë që të mbetet edhe kjo pikë në plan të punës për vitin 2023. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENIDT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

##### **4. Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- materialin e planit të punës së komiteteve konsultative e keni pasur dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTUA PLANI I PUNËS SË TRI KOMITETET KONSULTATIVE PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- kjo rregullore po bëhet për herë të parë dhe ka të bëje me menaxhimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës. Materialin e keni pranuar ne kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- e inkurajojë drejtorin për punën që e ka bërë në këtë rregullore por nuk pajtona me atë që potencon që për herë të parë.

**Sherif Berisha** thekson:- a është bërë pranimi teknik i Shtëpisë së Kulturës nga Ministria . tarifat të cilat janë përcaktuar në rregullore a do të mbisin vetëm i shifra për shkak se i kemi pasur por nuk janë realizuar.

**Hisni Luri** thekson:- ende nuk është bërë pranimi teknik por edhe nuk kemi staf të mjaftueshmë për me u kompletuar , mirëpo ideja është që ta kemi një rregullore e cila e përcakton edhe menaxherin që do ta ketë shtëpia e kulturës dhe besoj që do të merret edhe me çështjen e tarifave që besoj që do të shkon mirë e nuk do të mbeten vetëm në letër.

**Kryesuesi** thekson:- çështja e ndëshkimeve për personat të cilët e keqpërdorin sallën si është e rregullime.

**Hisni Luri** thekson:- nen 15 i paraqet masat ndëshkuese: Ndaj palëve të cilët nuk e respektojnë rendin Shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit do të merren masa ndëshkuese; Suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës me kohëzgjatje të lirë për t'u përcaktuar nga përgjegjësi i objektit dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njëjtë veprim, atëherë i merret e drejta për shfrytëzim, derisa subjekti ose organizata në fjalë është i përbërë nga të njëjit akter; Për dëmet eventuale të shkaktuara nga subjekti apo organizatat tjera përkatëse, përgjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit përgjegjësia bie te shfrytëzuesi, i cili duhet ti bëjë kompensimet në afat prej (5) ditëve në xhirologarinë e komunës së Hanit të Elezit. Sipas dispozitave të parapara në marrëveshjen për shfrytëzim të objektit; Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej tre anëtarëve i emëruar nga DAKRS-ja. Në rast të moskompenzimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit (2) të këtij nen, iniciohet procedura gjyqësore përmes përmbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për shfrytëzim deri në zgjedhjen e kontestit.

**Refet Kalisi** thekson:- a keni sistematizim të vendeve të punës.

**Hisni Luri** thekson:- edhe më herët kemi bërë kërkesë për sistematizimin e vendeve të punës dhe për stafin që na nevojitet te Shtëpia e Kulturës . Së bashku me drejtoreshën për buxhet dhe financa kemi parashtuar kërkesë në Ministrinë përkatëse por na kanë sugjeruar me ju drejtuar me kërkesa të tillë për shkak se nuk janë marr për bazë.

**Sherif Berisha** thekson:- a është shtuar zërimi dhe a është në nivel dhe çështja e ventilimit a është rregulluar dhe është mirë si drejtori me i shikuar këto çështje se a janë në rregull.

**Hisni Luri** thekson:- pranimi teknik ende nuk është bërë dhe ka pjesë që duhet të sanohen aty. Për momentin nuk e kemi zërimin që e ka shtëpia e kulturës dhe kemi funksionuar me zërim tjetër të SHKA Sharri . Sa i përket klimave kemi mungesë stafi dhe besoj se në të ardhmen këto çështje do të rregullohen

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## **5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- viti shkollorë 2022/2023 është paraparë që të fillon me datë një shtatorë por fatkeqësisht nuk ka filluar për shkak të grevës që është organizuar nga SBASH-ku, mirëpo ne i kemi bërë përgatitjet e duhura për me filluar procesi mësimorë.

**Kryesuesi** thekson:-nxënësit të cilët e kanë përsëritur vitin dhe që i dërgoni në Kaçanik , a specifikohet me rregullore që me u dërguar me një shkollë në komunë tjetër apo me ndonjë shkollë më të përfit.

**Hisni Luri** thekson:- profesorët e kanë vlerësuar se mënyrë tjetër për me ngritur cilësinë nuk kemi dëgjimi i kanë mbajtur parimet e veta. Provimet janë mbajtur dhe ata të cilët kanë mësuar e kanë kaluar provimin dhe ata të cilët nuk kanë mësuar e kanë përsëritur vitin dhe duhet të shkojnë me ndonjë shkollë më të përafert dhe shkolla më e përafert është në Kaçanik dhe Udhëzimi Administrativ e parashevë këtë çështje.

**Kryesuesi** thekson:- ka raste që nxënësit me nga njëmbëdhjetë nota të dobëta po e ndërojnë shkollën dhe përsëri ata nxënës po kthehen në të njëjtën shkollë dhe kush i kontrollon këto çështje.

**Hisni Luri** thekson:- nëse kthehen e kanë të drejtët e transferit dhe nuk mundemi me ja mohuar.

**Kryesuesi** thekson:- transferi mund të bëhet por duhet t'i kërkohen kushte dhe nuk është mirë që nxënësve që janë problematik me ua mundësuar këto gjëra.

**Sherif Berisha** thekson:- a keni ndonjë shkresë nga Ministria për fillimin e vitit shkollorë dhe nëse ka a ju ka përcjell shkollave.

**Hisni Luri** thekson:- në momentin që pranoj ndonjë shkresë në të cilën parashihet që me ua dërguar drejtorëve ua përcjelli me një herë.

**Kryesuesi** thekson:- është mirë të na njoftoni me paralelen e ndarë në shkollën e fshatit Krivenik.

**Hisni Luri** thekson:- paralelja shkollore e cila është në fshatin Krivenik do të bartet në paralelen shkollore në fshatin Seçishtë. Jemi dakorduar me shumicën e fshatit Krivenik dhe kemi bërë një transport enkas për bartjen e nxënësve po ashtu do t'i shqyrtojmë mundësitet për ndryshimin e orarit mësimorë që do të bëhet nga ora nëntë deri në orën trembëdhjetë. Në çerdhe janë të regjistruar 52 fëmijë të moshave të ndryshme dhe është bërë një investim në çerdhe.

**Ibadete Kalisi** thekson:- a do të kompensohen orët e humbura.

**Hisni Luri** thekson:- varet si do të bëhet marrëveshja në mes Qeverisë dhe Sindikatës.

**Refet Kalisi** thekson:-te çerdhja për fëmijë së bashku me stafin 62 e është vetëm një kuzhiniere dhe është mirë me shtuar stafin.

**Hisni Luri** thekson:- do t'i shikojmë mundësitet për këtë çështje.

**Sherif Berisha** thekson:- në të ardhmen është mirë me menduar për ndonjë aneks shkollorë sepse më lehtë i realizueshëm se sa po bisedohet për çështjen e shkollës në Lagje të Re.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

## 6. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- këtë pikë të rendit të punë e kemi pasur edhe më herët në kuvend të komunës po nga ana e Ministrisë na është kërkuar ti bëjmë disa ndryshime të cilat i kemi paraqitur në shkresë dhe është parashtruar nevoja që me i shtuar disa mjete financiare në projektet kapitale e që është dashur krejtsishtë ta ndryshojmë dhe me pezulluar atë lëndë. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U VOTUA KËRKESA PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË E SHPENZIMEVE KAPITALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

## 7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Refet Kalisi** thekson:- te projekti i parkut “Isa Berisha” që janë duke u zhvilluar punimet a ekziston mundësi me u vendosur një pano që e përcakton formën e punimeve dhe çka do të punohet në mënyrë që me pasur në punishte se qytetarët mund ta shikojnë se çka do të punohet.

**Nexhmedin Daci** thekson:- tabela informuese është obligim ligjorë i punë kryesit dhe do bisedoj me punë kryesin që me vendosur.

**Sherif Berisha** thekson:- kuroj informacion për çështjen e iniciativë që është formuar për blerjen e pronë për ndërtimin e shkollës në Lagje të Re.

**Sevdi Dernjani** thekson:- është OJQ dhe komuna vetëm e mbështetë. Është iniciativë qytetare dhe më detajishtë njoftimin e ke në fesbuk.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:25.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florimi Shkreta